



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
MUNICIPAL OF ASSEMBLY IN DRAGASH
SKUPSTINA OPSTINE DRAGAS



NJOFTIM

Komuna e Dragashit është në proces të organizmit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për Buxhetin e vitit 2027. Me qëllim të sigurimit të gjithëpërfshirjes, me theks në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme qytetare, Komuna e Dragashit ka përpiluar dhe publikuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore për Buxhetin e vitit 2027. Për këtë qëllim, ekzekutivi i Komunës gjatë muajit gusht ka paraparë të organizohen dy (2) dëgjime buxhetore me qytetarë dhe grupe të ndryshme të interesit.

Andaj, me qëllim të angazhimit aktiv dhe planifikimit të buxhetit të Komunës bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Komuna e Dragashit ju fton në:

Dëgjimin buxhetor me grupe të nënpërfaqësuar (gra, vajza, përfaqësues të komunitetit joshumicë, pensionistë, persona me nevoja të veçanta etj.)

KOHA: E hënë, 24 Gusht 2026, Ora 11:00

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale në Dragash

Kalendarin e organizmit të dëgjimeve buxhetore mund ta gjeni në këtë link: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Kalendari-i-protokolluar-shqip.pdf>

Informacionet për projekt-buxhetin dhe dokumentet tjera buxhetore mund t'i gjeni në këto linqe:
<https://dragash.rks-gov.net/degjimet-buxhetore/?tax=draft-buxheti>
<https://dragash.rks-gov.net/financat/>

Nëse nuk keni mundësi për të marrë pjesë me prezencë fizike në këtë takim, kërkesat, komentet dhe sugjerimet për Buxhetin e vitit 2027 mund t'i dërgoni në këto email adresa: qamil.kolloni@rks-gov.net, burim.aliu@rks-gov.net dhe fari.kolloni@rks-gov.net

Me respekt,

Zyra për Informim – Komuna e Dragashit